



XVI^e Congrès de la Conférence des Cours constitutionnelles européennes
XVIth Congress of the Conference of European Constitutional Courts
XVI. Kongress der Konferenz der Europäischen Verfassungsgerichte
XVI Конгресс Конференции европейских конституционных судов

**Rapport national / National report / Landesbericht /
национальный доклад**

RÉPUBLIQUE D'ALBANIE / REPUBLIC OF ALBANIA /
REPUBLIK ALBANIEN / РЕСПУБЛИКА АЛБАНИЯ

The Constitutional Court of the Republic of Albania
Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë

langue maternelle / native language /
Muttersprache / родной язык

XVith Congress of the Conference of European Constitutional Courts in 2014

Cooperation of Constitutional Courts in Europe – Current Situation and Perspectives

Questionnaire for the national reports

I. Constitutional courts between constitutional law and European law

1. Is the constitutional court obliged by law to consider European law in the performance of its tasks?

Republika e Shqipërisë nuk është anëtare e Bashkimit Europian. Megjithatë Shqipëria, ka ratifikuar MSA-në e cila hyri në fuqi më 1 prill 2009, (pas ratifikimit të saj nga 25 vendet anëtare të BE-së, të cilat ishin pjesë e BE-së në momentin e nënshkrimit të MSA-së,) si dhe miratimin e saj nga Parlamenti shqiptar.

Gjykata Kushtetuese nuk është e detyruar me ligj që të marrë në konsideratë të drejtën evropiane por respekton parimet dhe standardet e përgjithshme dhe detyrimet që burojnë nga kjo marrëveshje.

2. Are there any examples of references to international sources of law, such as

- a) the European Convention on Human Rights,*
- b) the Charter of Fundamental Rights of the European Union,*
- c) other instruments of international law at European level,*
- d) other instruments of international law at international level?*

a. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimet e saj i referohet shpesh Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, veçanërisht përsa i përket gjykimit të kërkesave të individëve për pretendimin e shkeljes së nenit 6 të Konventës për një proces të rregullt ligjor. Që nga viti 2005, Gjykata Kushtetuese i është referuar KEDNJ në mbi 150 çështje.

b. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë i është referuar Kartës së të Drejtave Themelore të BE vetëm në një rast (vendimi V. nr. 47, datë 07.11.2011, në lidhje me parimin *ne bis in idem*).

c. Në vendimet e saj Gjykata Kushtetuese i është referuar në vendimet e saj këtyre instrumenteve të së drejtës ndërkombëtare në nivel evropian:

1. Konventa e Këshillit të Evropës “Për ndihmën e ndërsjelltë në fushën penale”
V. nr.41, datë 29.12.2005
V. nr. 14, datë 17.04.2007
V. nr. 23, datë 23.07.2009
2. Kodi i praktikës së mirë në çështjet zgjedhore i Komisionit të Venecias.
V. nr. 1, datë 07.01.2005
V. nr.32, date 21.06.2010
3. Karta Europiane e Autonomisë Vendore
V. nr. 29, datë 21.12.2006
V. nr. 3, datë 02.02.2009

- V. nr. 22, datë 05.05.2010
- V. nr. 48, datë 08.10.2011
- 4. Karta Europiane mbi Statusin e gjyqtarëve
 - V. nr. 25, datë 05.12.2008
 - V. nr. 20, datë 09.07.2009
 - V. nr. 26, datë 24.07.2009
 - V. nr. 31, datë 02.12.2009
 - V. nr. 11, datë 06.04.2010
- 5. Konventa e Këshillit të Evropës për Trasferimin e Procedimeve
 - V. nr. 23, datë 23.07.2009
- 6. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit me Komunitetin Evropian
 - V. nr. 24, datë 24.07.2009
- 7. Direktiva 2006/43/EC e BE-së “Për Auditimin e Detyrueshëm të Llogarive Vjetore”
 - V. nr. 3, datë 05.02.2010
- 8. Rekomandim nr. R (2000) 21, i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës
 - V. nr. 7, datë 12.03.2010
- 9. Rekomandim nr. R (94) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës “Mbi pavarësinë, eficiencën dhe rolin e gjyqtarëve”
 - V. nr. 11, datë 06.04.2010
- 10. Karta e Parimeve Bazë të Profesionit Ligjor Evropian, miratuar nga Këshilli i Dhomave të Avokatisë dhe Shoqërive Ligjore të Europës (CCBE)
 - V. nr. 7, datë 12.03.2010
- 11. Protokoll i Dytë Shtesë i Konventës Evropiane për Ekstradimin, dt. 17.03.1978
 - V. nr. 21, datë 29.04.2010
- 12. Konventa Europiane mbi të drejtat e fëmijës
 - V. nr. 12, datë 15.04.2011
 - V. nr. 35, datë 25.07.2011
- 13. Rezoluta (75)11 e Komitetit të Ministrave të KE “Për kriteret e gjykimit në mungesë”
 - V. nr. 45, datë 10.10.2011
- 14. Rezoluta e Asamblesë Parlamentare të KE nr.1335 (2003)
 - V. nr. 52, datë 01.12.2011
- 15. Rekomandimi i Asamblesë Parlamentare të KE nr. 1735 (26.1.2006)
 - V. nr. 52, datë 01.12.2011
- 16. Konventa Kuadër e KE për Mbrojtjen e Minoriteteve
 - V. nr. 52, datë 01.12.2011

d. Përsa i përket instrumentave të tjerë të së drejtës ndërkombëtare në nivel ndërkombëtare, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë i është referuar:

- 1. Pakti Ndërkombëtar lidhur me të drejtat Politike Civile
 - V. nr.35, datë 20.12.2005
 - V. nr. 14, datë 17.04.2007
 - V. nr. 11, datë 02.04.2008
 - V. nr. 4, datë 25.02.2009
 - V. nr. 20, datë 09.07.2009
 - V. nr. 1, datë 25.01.2010
 - V. nr. 9, datë 23.03.2010
- 2. Konventa e Gjenevës mbi “Statusin e Refugjatit”
 - V. nr. 4, datë 28.02.2006
- 3. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore

- V. nr. 9, datë 23.03.2010
4. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
V. nr. 11, datë 02.04.2008
V. nr. 20, datë 09.07.2009
V. nr. 9, datë 23.03.2010
 5. Konventa e OKB-së për të Drejtën e Detit
V. nr. 15, datë 15.04.2010
 6. Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve, dt. 23.05.1969
V. nr. 15, datë 15.04.2010
 7. Parimet Themelore të Rolit të Avokatit, miratuar nga Kongresi i Kombeve të Bashkuara në vitin 1990
V. nr. 7, datë 12.03.2010
 8. Konventa kundër Torturës dhe Akteve Çnjerëzore e Degraduese
V. nr. 14, datë 03.05.2011

3. Are there any specific provisions of constitutional law imposing a legal obligation on the constitutional court to consider decisions by European courts of justice?

Aktualisht nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë që të parashikojë detyrimin e Gjykatës Kushtetuese për të marrë në konsideratë vendimet e Gjykatës evropiane të Drejtësisë, pasi Shqipëria nuk është anëtare e BE-së. Pavarësisht kësaj, Gjykata Kushtetuese mund të bëjë pjesë të vendimmarrjes së saj standarde dhe parime të elaboruara nga gjykatat evropiane të drejtësisë përsa ato lidhen me çështje konkrete në shqyrtim nga ana e saj.

4. Is the jurisprudence of the constitutional court influenced in practice by the jurisprudence of European courts of justice?

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë i është referuar rrallë praktikës së gjykatave evropiane të drejtësisë. Në jurisprudencën e saj ajo i është referuar në vendimin V. nr. 10, datë 19.03.2008 në lidhje me parimin e veprimtarisë së lirë ekonomike.

5. Does the constitutional court in its decisions regularly refer to the jurisprudence of the Court of Justice of the European Union and/or the European Court of Human Rights? Which are the most significant examples?

Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj i referohet vazhdimisht jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Që nga viti 2000 ajo i është referuar kësaj jurisprudence në rreth 80 çështje. Shembujt më të rëndësishëm janë:

- V.41 datë 19.07.2012 referon vendimet Gurov v. Moldova, Posokhov v. Russia, Fedotova v. Russia; DMD GROUP, A.S. v. Slovakia.
- V.52 datë 5.12.2012 referon vendimet Marper kundër Mbretërisë së Bashkuar, Coster kundër Mbretërisë së Bashkuar, Faber kundër Hungarisë, Nada kundër Zvicrës.
- V.52 datë 1.12.2011 referon vendimet Burghartz kundër Zvicrës, Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar, Niemietz kundër Gjermanisë, Rotaru kundër Rumanisë, S. dhe Marper kundër Mbretërisë së Bashkuar, Ciubotaru kundër Moldavisë.
- V. 47, datë 7.11.2011 referon vendimet Von Hoffen kundër Litenshtejnit, Hozee kundër Hollandës, Ferrantelli and Santangelo, Wettstein kundër Zvicrës.
- V. 20, datë 01.06.2011 referon Xheraj kundër Shqipërisë

- Vendimi nr. 4, datë 23.02.2011 referon Raimonondo v. Italisë, Agosi kundër Mbretërisë së Bashkuar, Arcuri dhe të tjerë kundër Italisë.
- Vendimi nr. 9, datë 23.03.2010 referon Ždanoka kundër Letonisë, Adamson kundër Latvia, Turek kundër Sllovakisë; Matyjek kundër Polonisë; Luboch kundër Polonisë; Bobek kundër Polonisë; Žičkus kundër Lituanisë; Ždanoka kundër Letonisë dhe Adamsons kundër Letonisë.
- Vendimi nr. 30, datë 17.06.2010 referon Somogyi kundër Italisë, Sejdocic kundër Italisë
- Vendimi nr. 27, datë 26.05.2010 referon Driza kundër Shqipërisë
- Vendimi nr. 18, datë 23.04.2010 referon Albert dhe Le Compte kundër Belgjikë, Kreuz kundër Polonisë
- Vendimi nr. 17, datë 23.04.2010 referon Sporrang & Lönnroth v. Suedisë (1982), dhe Lithgow v. Mbretërisë së Bashkuar, 1986).
- Vendimi nr. 12, datë 14.04.2010 referon Gurepka v. Ukrainës, Bendenoun v. Francës, Engel v. Hollandës dhe Janosevic v. Suedisë

6. Are there any examples of divergences in decisions taken by the constitutional court and the European courts of justice?

Siç e theksuam edhe më lartë, Shqipëria nuk është anëtare e BE-së dhe nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë që të parashikojë detyrimin e Gjykatës Kushtetuese për të marrë në konsideratë vendimet e Gjykatës evropiane të Drejtësisë, për këtë arsye GJK i është referuar rrallë herë asaj. Nuk ka ndonjë studim apo vlerësim konkret në lidhje nëse ka divergjenca në vendimmarrjen e këtyre dy gjykatave.

Në jurisprudencën e deritanishme të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nuk janë vërejtur divergjenca midis vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, për rastin e referuar në vendimin e saj (V. nr. 10, datë 19.03.2008 i GJK).

7. Do other national courts also consider the jurisprudence of European courts of justice as a result of the constitutional court taking it into consideration in its decisions?

Gjykatat kombëtare i referohen kryesisht legjislacionit të brendshëm dhe rrallë herë i referohen Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, por jo Gjykatave Evropiane të Drejtësisë.

8. Are there any examples of decisions by European courts of justice influenced by the jurisprudence of national constitutional courts?

Në Shqipëri nuk ka shembuj të influencës së vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë mbi vendimet e Gjykatave Evropiane të Drejtësisë.

II. Interactions between constitutional courts

1. Does the constitutional court in its decisions refer to the jurisprudence of other European or non-European constitutional courts?

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në jurisprudencën e saj i referohet edhe jurisprudencës së Gjykatave Kushtetuese të vendeve europiane ose jo europiane. Rastet më të spikatura janë:

V. nr.14, datë 05.07.2005
V. nr.30, datë 01.12.2005
V. nr.32, datë 02.12.2005
V. nr.34, datë 20.12.2005
V. nr.20, datë 11.07.2006
V. nr.22, datë 26.07.2006
V. nr.24, datë 10.11.2006
V. nr. 23, datë 08.06.2007
V. nr. 26, datë 13.04.2007
V. nr. 35, datë 10.10.2007
V. nr. 40, datë 16.11.2007
V. nr. 10, datë 19.03.2008
V. nr. 4, datë 25.02.2009
V. nr. 1, datë 25.01.2010
V. nr. 9, datë 23.03.2010
V. nr. 15, datë 15.04.2010
V. nr. 21, datë 29.04.2010
V. nr. 32, datë 21.06.2010
V. nr. 4, datë 23.02.2011
V. nr. 19, datë 01.06.2011
V. nr. 20, datë 01.06.2011
V. nr. 44, datë 07.10.2011
V. nr. 48, datë 08.10.2011

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë i referohet kryesisht vendimeve të Gjykatave kushtetuese, italiane, Gjykatave gjermane, këshillit kushtetues francez dhe gjykatave kushtetuese të vendeve të lindjes.

2. If so, does the constitutional court tend to refer primarily to jurisprudence from the same language area?

E vetmja Gjykatë Kushtetuese e cila i harton vendimet në të njëjtën gjuhë me Gjykatën shqiptare është Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Në jurisprudencën e deritanishme, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ende nuk i është referuar një vendimi të kësaj gjykatë.

3. In which fields of law (civil law, criminal law, public law) does the constitutional court refer to the jurisprudence of other European or non-European constitutional courts?

Gjykata Kushtetuese e referon jurisprudencën e gjykatave të tjera kushtetuese evropiane dhe jo evropiane në fushën civile, penale dhe atë publike.

4. Have decisions of the constitutional court noticeably influenced the jurisprudence of foreign constitutional courts?

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese shqiptare nuk kanë ndonjë influencë të dukshme në jurisprudencën e gjykatave të tjera kushtetuese, ndërkohë që jurisprudenca e tyre ka ndikim në jurisprudencën shqiptare. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë i referohet jurisprudencës së Gjykatave kushtetuese të Italisë, Gjykatës Kushtetuese federale gjermane, gjykatave kushtetuese të vendeve të lindjes.

5. Are there any forms of cooperation going beyond the mutual acknowledgement of court decisions?

Format e bashkëpunimit midis gjykatës kushtetuese shqiptare dhe gjykatave të tjera kushtetuese janë të formave të ndryshme: konferenca, seminare, takime bilaterale, tryeza të rumbullakëta. Me Gjykatën Kushtetuese italiane dhe atë të Kosovës kemi lidhur marrëveshje bashkëpunimi reciprok në fusha me interes të përbashkët.

III. Interactions between European courts in the jurisprudence of constitutional courts

1. Do references to European Union law or to decisions by the Court of Justice of the European Union in the jurisprudence of the European Court of Human Rights have an impact on the jurisprudence of the constitutional court?

Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut ka ndikim në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese shqiptare për vendosje dhe ruajtjen e standardeve kushtetuese.

2. How does the jurisprudence of constitutional courts influence the relationship between the European Court of Human Rights and the Court of Justice of the European Union?

3. Do differences between the jurisprudence of the European Court of Human Rights, on the one hand, and the Court of Justice of the European Union, on the other hand, have an impact on the jurisprudence of the constitutional court?

Jurisprudenca e GJEDNJ-së ka ndikim në jurisprudencën e GJK madje në disa raste ajo ka çuar edhe në ndryshimin e praktikës së saj.

P.sh në lidhje me mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë. (Deri në vitin 2006 Gjykata Kushtetuese nuk e konsideronte ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë si pjesë të procesit të rregullt ligjor. Për pasojë këto lloj kërkesash nuk pranoheshin, pasi konsideroheshin se nuk hynin brenda juridiksionit të kësaj gjykate. Kjo kategori çështjesh rezultoi të jetë përfshirë tepër vonë në praktikën e Gjykatës Kushtetuese, më saktë pas vendimit të GJEDNJ në çështjen *Qufaj v. Albania* (vendim i datës 18.09.2004), në të cilën aplikanti pretendoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ për shkak të moekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga shteti shqiptar. Në këtë çështje GJEDNJ theksoi se “dispozitat për procesin e rregullt gjyqësor në Shqipëri duhej të ishin interpretuar në mënyrë të tillë që të garantonin një mjet ankimor efektiv për shkeljen e pretenduar të nenit 6(1) të Konventës”, prandaj ajo vlerësoi se Gjykata Kushtetuese ishte kompetente të shqyrtonte

kërkesën e aplikantit në lidhje me mosrespektimin e një vendimi përfundimtar, si pjesë e juridiksionit të saj për të siguruar të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor.

Nisur nga ky qëndrim i GJEDNJ, Gjykata Kushtetuese ndryshoi jurisprudencën e saj duke i pranuar për shqyrtim të tilla kërkesa dhe duke e konsideruar ekzekutimin e vendimeve si pjesë e procesit të rregullt ligjor, pra si pjesë të juridiksionit të saj. Vendimi i parë që shënoi kthesën në jurisprudencën kushtetuese është ai nr.6, datë 31.03.2006.